



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.08.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " DWH ALBANIA " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS " , Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " DWH-ALBANIA " SH.P.K. e dt.12.08.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS " , Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 04.08.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË** , i publikuar me datë: 04.08.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.12.08.2022, Operatori Ekonomik " DWH ALBANIA" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me instrument GPS " , Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.08.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Se pari ju kujtojm se 10 pyetjet e juaja kanë marrë përgjigje me dt.09.08.2022, kur në sistemin e e-prokurimit janë ngarkuar sqarimet shtesë.

Përgjigje 1.

- Sipas Ligjit për Prokurim Publik 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 saktësisht neni 28 Specifikimet teknike , paragrafi 1 thotë, citat paragrafi" Autoriteti kontraktues do ti parashtojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit, dhe paragrafi 2, i cili thotë, citat paragrafi" Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

- Bazuar ne këta dy paragrafë e sidomos paragrafi 2 tregon qartë se AK ka përpiluar specifikime teknike ne harmoni me qëllimin e prokurimit dhe pa ndonjë diskriminim te caktuar sepse as ju vetë si OE ankues nuk keni dhënë dëshmi se cilit model i përshtaten këto specifikime apo per cilat arsyeje ju nuk mund te ofertoni, mirëpo vetëm keni paragjykuar përshtatjen e specifikimeve teknike dhe ketë e bazojmë ne faktin se ju ankoheni edhe per Windows 10 ku edhe kompania Leica qe ju përfaqëson ka dy modele te këtij lloji, prandaj te gjitha arsyetimet e juaja janë tendencioze dhe vetëm kanë për qëllim imponimin e zgjidhjes se juaj për neve si Autoritet Kontraktues.

Përgjigje 2 dhe 3, janë kërkuar specifika te përgjithshme, pra çdo produkt I juaji dhe I çdo prodhuesi I plotëson këto kërkesa, ne nuk shohim ndonjë shkelje këtu.

Përgjigje 3. Për ketë arsye është kërkuar IP e larte, qe te jete ne mbrojtje nga kushtet atmosferike, pra te siguroj pune edhe ne kushte ekstreme. Kjo është edhe njëra nga ankesat e juaja pse kemi kërkuar IP te larte, kurse tani vete e potenconi qe për Kontroller duhet te jete I përgatitur për kushte ekstreme.

Tek IP jeni te mirëpritur te sjellni produktin qe ju e posedoni si prodhues Leica:

1. <https://leica-geosystems.com/products/total-stations/controllers/leica-cs30> , ky kontrollor është edhe me Windows 10 edhe me IP 68.

Cdo ankes e juaj eshte bere te ule rendimentin e produkteve, ankesat kan qene per Windows 10 edhe IP68 tek knotrleri, Ne si AK ju vejme ne dijeni qe njeri nga produktet e juaj I ploteson keto kerkesa edhe Windonws 10 edhe IP 68, pra jeni te lutur te ofertoni kete produkt <https://leica-geosystems.com/products/total-stations/controllers/leica-cs30> dhe ju sigurojme qe do te mirepritni.

Pra nese ky produkt I juaji e ploteson cdo kerkes tonen, ateher pse duhet te ankoheni per te ul specifikat!?

- **Gjeni te bashkengjitur ne fotografine e meposhtme edhe specifikat qe produkti juaj I ploteson kushtet:**



leica-geosystems.com

- when it has to be right



Leica CS30



SYSTEM		CONNECTIVITY - WIRELESS	
Operating System	Microsoft® Windows® 10 LTSC 64bit	WLAN	802.11 a/b/g/n/ac (2.4 & 5GHz)
Processor	Intel® ApolloLake N3550 1.1GHz up to 2.4GHz 32GB eMMC	Bluetooth*	v4.2
Memory	4 GB RAM 64 GB eMMC Storage	Cellular Modem	Worldwide 3G/4G LTE
Screen	7.0 inch Resolution 1280x800 LCD type IPS 10 points capacitive multi-touch Corning® Gorilla® Glass 3 Sunlight-readable	CONNECTIVITY - RANGE	
Hardware keys	Power button, 2 function keys	Standard Bluetooth*	≈ 100 m
Weight (Including Battery)	760 g	Long-range Bluetooth*	≈ 600 m
CS30 Tablet	67 g	SECURITY	
CTR30 LRBT Module	30 g	Hardware	Kensington lock theft protection
GAT25 Antenna	30 g	Software	Trusted Platform Module (TPM)
Dimensions	210 x 140 x 23 mm	INTEGRATED SUPPORTING SYSTEMS	
CS30 Tablet	84 x 80 x 25 mm	Camera	8 MP
CTR30 LRBT Module	31 x 20 x 117 mm	Flash	Dual-LED
GAT25 Antenna	31 x 20 x 117 mm	GNSS	uBlox NEO-M8N
Battery	Hot-swappable Indicator LEDs 11.1V 3000mAh (33.3 Wh) Working time 5 hours	Sensors	Accelerometer Gyroscope Ambient light sensor Compass
ENVIRONMENTAL		Audio	Microphone & speaker
Dust Resistance	IP6x	REGULATORY	
Water Resistance	IPx6 (spray) IPx8 (submersion)	Australia & New Zealand	RCM


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës